

mk@eu

PROGRAMET E

BASHKËSISË

FONDACIONI INSTITUTI SHOQËRIA E HAPUR - MAQEDONI
QENDRA MAQEDONASE PËR ARSIM EVROPIAN

PROGRAMET E BASHKËSISË

Botimi i dytë

Shkup, prill 2010

PROGRAMET E BASHKËSISË

Boton:

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Milçin, Drejtor ekzekutiv

Autorë:

Qendra maqedonase për arsim evropian

Përkthimi:

ABAKUS

Formësimi artistik-grafik:

Brigada Dizajn

Shtyp:

Skenpoint

Tirazhi: 1000 copë

Republika e Maqedonisë e fitoi statusin e shtetit-kandidat në vitin 2005 - kaluan pesë vite që nga kjo datë, por shteti edhe më tej nuk i ka filluar bisedat për anëtarësim.

Projekti "Aksioni për Evropë" ka për qëllim të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e përshpejtimit të procesit të aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Projekti planifikohet si një serial i ngjarjeve për promovimin e Bashkimit Evropian dhe përfitimet e Republikës së Maqedonisë nga anëtarësimi në BE, përfshirë edhe debatet për sfidat e Republikës së Maqedonisë në rrugën drejt BE-së. Projekti ka filluar në vitin 2009 dhe ka vazhduar në komunat tjera gjatë vitit 2010. Kjo broshurë duhet t'i sigurojë qytetarëve informata themelore për programet e bashkësive dhe domethënien e tyre, t'i përgatisë për marrjen e informatave për programet në Maqedoni dhe të kuptojnë si duhet të duket një projekt i suksesshëm që do të financohej përmes programit gjegjës të bashkësive. Presim që broshura ta rrisë presionin dhe përkushtimin e qytetarëve mbi të gjithë pjesëmarrësit e aderimit të Republikës së Maqedonisë në BE, për plotësimin e rekomandimeve kyçe të Partneritetit për anëtarësim dhe të sigurojë rekomandim për fillimin e negociatave për anëtarësim, përmes Raportit për progresin e vitit 2009 nga Komisioni Evropian.

Broshura realizohet si pjesë e aktiviteteve në kuadër të projektit "Aksioni për Evropë", që realizohet nga Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni, në bashkëpunim me Qendrën maqedonase për arsim evropian, Forumin rinor arsimor, Qendrën rinore kulturore nga Manastiri dhe 12 qendrat e burimit për përkrahjen e organizatave joqeveritare¹, që funksionojnë në 12 komuna² në Maqedoni.

¹ Fondacioni për zhvillimin e bashkësisë lokale - Shtip, Fondacioni për zhvillim lokal dhe demokraci Fokus - Veles, Qendra për përkrahje dhe zhvillim - Prilep, Qendra për përkrahjen e bashkësive - Kërçovë, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë, Qendra për përkrahjen e bashkësive - Resnjë, Qendra për zhvillimin e qëndrueshëm të bashkësive - Dibër, Qendra rajonale për përfaqësim - Dellçevë, Qendra për zhvillim rajonal Antigonea - Negotinë, Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm - Kratovë, Akua - Strugë, QKR - Manastir dhe Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm - Gjevgjeli

² Kratova, Dellçeva, Strumica, Gjevgjelia, Negotina, Shtipi, Velesi, Prilepi, Kërçova, Dibra, Struga, Resnja

Në periudhën e ardhshme, Bashkimi Evropian duhet të plotësojë shumë detyra. Pas analizës së vitit 2005, me të cilën duhej të konstatohet pse nuk janë arritur prioritetet e përcaktuara paraprakisht, BE përcaktoi një sfidë të re - i emëroi prioritetet e reja për periudhën 2007-2013 në një kornizë tjetër strategjike, të quajtur Agjenda e re e Lisbonës.

Sfida është e jashtëzakonshme. TANI, Republika e Maqedonisë nuk guxon ta lëshojë këtë mundësi! Bashkimi Evropian do të përpiqet ta bëjë EVROPËN (jo vetëm shtetet-anëtare të BE-së) vend më atraktiv për investime dhe punë, përmes zgjerimit dhe përmirësimit të rrjetit transportues, lidhjes dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor me zhvillimin, si dhe do të përpiqet ta zgjidhë problemin e Evropës rreth shfrytëzimit intensiv të burimeve tradicionale të energjisë. Për ta arritur këtë, Bashkimi Evropian kupton që duhet ta përmirësojë njohurinë dhe inovacionet për stimulimin e zhvillimit ekonomik, që është e mundur vetëm përmes rritjes së investimeve në hulumtime dhe zhvillim teknologjik, nxitjes së sipërmarrësisë dhe promovimit të shoqërisë informatike për të gjithë, si dhe përmes qasjes më të mirë ndaj financave. Vetëm në këtë mënyrë, BE do ta plotëson qëllimin e saj: hapjen e vendeve të reja dhe më të mira të punës, me të cilat do të joshen dhe mbahen njerëzit në marrëdhënie pune, modernizimin e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe fleksibilitetin e shtuar të punëtorëve dhe ndërmarrjeve. Bashkimi Evropian e kupton qartë që nevojitet investim më i madh në kapitalin njerëzor, përmes arsimit më të mirë dhe aftësive të shtuara dhe që duhet të rritet kapaciteti administrativ, si dhe të sigurohet ndihmë për mbajtjen e forcës së shëndoshë të punës.

Që nga viti 2006, Republika e Maqedonisë është ftuar të mbetet pjesë e këtij rrëfimi të suksesshëm. Shumë prej të a.q. Programe të Bashkësisë³ janë hapur edhe për qytetarët tonë dhe i shërbejnë evropianizimit të shoqërisë tonë. Fatkeqësisht, shteti i jonë nuk i shfrytëzon shumë këto mundësi dhe i ka humbur të gjitha përfitimet e BE-së për qytetarët tonë, gjegjësisht evropianët e ardhshëm.

³ Programet e Bashkësisë janë fondet plotësuese që ofrohen nga BE për Republikën e Maqedonisë, që rrjedhin jashtë ndihmës para-anëtarësim IPA.

ÇKA JANË PROGRAMET E BASHKËSISË?

Një prej instrumenteve me të cilat Bashkimi Evropian do ta realizojë Agjendën e re të Lisbonës, janë edhe të a.q. Programet e Bashkësisë. Këto programe janë të holla speciale për projektet e ndryshme të shfrytëzuesve nga shtetet-anëtare, që duhet të kontribuojnë në integrimin e mëtejshëm të thelluar evropian në fushat e caktuara, që me kalimin e kohës mund të shndërrohen në politikë të përbashkët të BE-së. Së këndejmi, programet e këtilla koncentrohen në fushat që ruhen me xhelozë nga shtetet-anëtare për vete dhe nuk ia bartin injerencat BE-së, për shkak të ndjeshmërisë së tyre (arsimi, kultura, mediat, të drejtat e njeriut, etj) ose në fushat ku integrimi nuk mjafton ose mund të përmirësohet (doganat, tatimet, mbrojtja sociale, anti-diskriminimi etj), si dhe fushat e reja ku mund të zhvillohet politika e përbashkët, ku përmes rezultateve mund të fillohet procesi i politik-bërjes (energji, shtetësia evropiane, qytetarët aktivë, etj). Prapëseprapë, të gjitha shtetet-anëtare e kuptojnë që bashkëpunimi i ndërsjellë është shumë i rëndësishëm dhe për këtë arsye parashirojnë kërkesa në çdo shtatë vite, me të cilat kërkojnë perspektiva financiare nga Komisioni Evropian për zhvillimin dhe realizimin e programeve të këtilla.

Për të siguruar shfrytëzim më të mirë të mjeteve të ndara për programet e ndryshme të Bashkësisë, Komisioni Evropian i ka thjeshtësuar programet e përfshira me kornizën financiare 2007-2013. Konkretisht, tani ekzistojnë të a.q. programet-kornizë të cilat bashkojnë disa programe të kornizës paraprake financiare, me çka janë unifikuar rregullat. Për të pasur pasqyrë më të mirë të programeve që janë financuar më parë dhe që parashihen për periudhën 2007-2013, shikoni tabelën në fund të broshurës.

Meqë këto programe financohen nga buxheti i BE-së dhe buxheti mbushet nga qytetarët e shteteve-anëtare, të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve e kanë shtetasit e BE-së. Por, politika e zgjerimit nënkupton që një ditë, edhe shtetet me status kandidati, si që është Maqedonia, do të bëhen anëtare të BE-së dhe për këtë arsye është e dobishme që qytetarët e vendeve të këtilla të marrin pjesë në Programet e Bashkësisë. Në këtë mënyrë, ata hyjnë në rrjetet ekzistuese të BE-së dhe ndërtojnë rrjete të reja që mundësojnë nisjen e projekteve të përbashkëta.

Për të qenë e drejtë pjesëmarrja e këtyre shteteve, Komisioni Evropian kërkon pjesëmarrje financiare nga buxhetet e shteteve të interesuara, në mënyrë adekuate ndaj programeve konkrete. Kushtet, rregullat dhe procedurat e pjesëmarrjes janë të njëjta si për shtetet-anëtare, kurse pjesëmarrja financiare në secilin program rregullohet me nënshkrimin e Memorandumit për mirëkuptim, me të cilin parashihen kushtet e njëjta për kontroll financiar dhe revizion. Kjo pjesëmarrje financiare quhet edhe pagesa e «biletës hyrëse» ku shuma

caktohet përmes Memorandumit për mirëkuptim, për çdo program ndaras. Nëse të hollat nuk shfrytëzohen, të hollat për biletën hyrëse nuk kthehen, kështu që shtetet (në këtë rast, Republika e Maqedonisë), para zgjedhjes së programeve për pjesëmarrje duhet të mendojnë mirë se cilat organizata kanë kapacitet për tërheqjen e të hollave në emër të projekteve (të paktën ato që Maqedonia i paguan nga buxheti i saj) dhe jo cilat programe duken më joshëse. Komisioni Evropian kupton që shtetet si Republika e Maqedonisë kanë mjete të kufizuara, kështu që na lejon t'i shfrytëzojmë mjetet e IPA për bashkëfinancim të biletës hyrëse, sa për fillim. Bashkëfinancimi duhet ngadalë të zvogëlohet, gjatë tre viteve.

E drejta e pjesëmarrjes së shteteve-kandidate dhe shteteve-kandidate potenciale përcaktohet në nivel politik. Kjo ka ndodhur gjatë Këshillit evropian në Selanik në qershor 2003, kur me BE-në ka kryesuar Republika e Greqisë dhe është qartësuar që shtetet e Ballkanit perëndimor mund të anëtarësohen në BE. Njëherazi, Greqia ka konfirmuar që Procesi i stabilizimit dhe asociimit do të jetë korniza për integrim, duke i hapur dyert për Programin e bashkësisë, tuiningun dhe TAEX-in për Ballkanin perëndimor, si dhe instrumentet e reja që do ta përshpejtojnë përgatitjen për anëtarësim. Së këndejmi, perspektiva evropiane e Ballkanit perëndimor në BE njihet edhe si Agjenda e Selanikut.

KULTURA 2007-2013



Kultura e Maqedonisë nuk është vetëm maqedonase, por edhe evropiane! Krenohemi me atë që e kanë krijuar paraardhësit tonë, por kujtimi bëhet i pavdekshëm vetëm atëherë kur veprat e tyre, së bashku me prodhimet artistike dhe kulturore të krijuara nga ky vend, do të qarkullojnë jashtë kufijve të Maqedonisë, nën qiellin e përbashkët evropian.

Bashkimi Evropian e ndihmon lëvizshmërinë e kulturës dhe punëtorëve kulturorë me 354 milionë euro, në periudhën 2007-2013, përmes granteve për zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës në të gjitha shtetet evropiane. Bashkimi Evropian përpiqet ta nxisë vëllazërimin e qyteteve, ta zhvillojë turizmin dhe industrinë kulturore, t'i zgjerojë rrjetet e nevojshme për përhapjen më të lehtë të informatave kulturore në mbarë Evropën dhe t'i mundësojë artistëve dhe të a.q. operuesve kulturorë të lëvizin më lehtë dhe të organizojnë së bashku ngjarje dhe manifestime kulturore. Qendrat hulumtuese, pushtetet lokale, shtëpitë e kulturës, ndërmarrjet, sindikatat, shoqatat e qytetarëve, administratat, universitetet dhe operatorët tjerë kulturorë nga Evropa mund t'i shfrytëzojnë këto mjete për promovimin e lëvizshmërisë transnacionale të njerëzve, që punojnë në sektorin kulturor, duke e nxitur dialogun ndër-kulturor në të njëjtën kohë. Bashkimi Evropian i mbështet projektet disaveçare (deri në pesë vite) të organizatave të ndryshme partnere nga disa vende evropiane, me çka nxitet puna e organizatave aktive në nivel evropian dhe punohet për ruajtjen e kujtimeve për lokacionet dhe arkivat kryesore, që janë pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane. Duke i mbështetur këto aktivitete, Bashkimi Evropian njëherazi bën edhe analiza, mbledh dhe bart informata nga fusha e bashkëpunimit kulturor dhe do ta përcjellë evolucionin e bashkëpunimit kulturor. Si rezultat, do të krijohen ueb-veprat për këmbimin e praktikave më të mira.

Rrëfimi maqedonas

Xhaz-festivali i Shkupit është i njohur jo vetëm në nivel evropian, por edhe më gjerë. Nëse lidhet festivali i jonë me shtatë organizata tjera kulturore prej shtatë shteteve të ndryshme evropiane, atëherë do të fitojë dimension mbi-nacional dhe do të ketë vlerë të shtuar evropiane. Festivali do të bëhet shumë më i njohur dhe do të joshin muzikantë nga shtetet tjera evropiane, në radhë të parë ata që vijnë prej organizatave-partnere. Më e mira e këtij rrëfimi është që Bashkimi Evropian është i gatshëm t'i financojë këto festivale, për shkak se ato e promovojnë kulturën «evropiane».

AguxonRepublikaeMaqedonisë t'i lejojë vetestë përjashtohet nga këto procese kulturore? A guxojmë t'i lëshojmë përfitimet nga veprimi i përbashkët në nivel evropian? Pse i shpenzojmë mjetet buxhetore për përkthimin e autorëve evropianë, kur shpenzimet për përkthim parashihen në programin Kultura? Dhe më e rëndësishmja se të hollat, fakti që gjuha maqedonase do të jetë njëra prej gjuhëve të përdoren në Evropë. Pse të mos i pranojmë praktikën e dëshmuara evropiane si më të mira dhe të mos e plotësojmë rrëfimin me kulturën maqedonase? Në fund, a nuk kemi obligim ndaj krijuesve kulturorë në të kaluarën, por edhe për të gjithë artistët, muzikantët, aktorët, arkeologët, arkitektët, folkloristët, vallëzuesit, performuesit e ardhshëm dhe shumë tjerë nëpunës kulturorë nga Maqedonia t'i japim mundësi të ndiejnë se i takojnë një mjedisi më të gjerë kulturor evropian?

Për t'ia mundësuar qytetarëve të BE-së marrjen më të lehtë dhe më të shpejtë të informatave për këtë program, BE ka parashikuar krijim dhe mbështetje të të a.q. kontakt-pikave kulturore në të gjitha shtetet-pjesëmarrëse të programit. Prej tyre pritet t'i përhapin informatat tek të gjitha palët e përfshira në vend, t'i ndihmojnë pjesëmarrësve të ardhshëm, ta promovojnë programin dhe rezultatet e saj, etj. Përveç Ministrisë së kulturës, që është përgjegjëse për këtë program, në Republikën e Maqedonisë ekziston edhe Kontakt-pika kulturore (KPK), që funksionon si seksion i veçantë në kuadër të Sektorit për euro-integrime në Ministrinë e kulturës. Kontaktet mund të realizohen në këtë ueb-faqe dhe adresë:

Ministria e kulturës

(objekti - Nova Makedonija, zyra 334)
Rr. Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn
1000 Shkup, Maqedoni

KPK Maqedoni

www.ccp-macedonia.gov.mk
E-mail: office@ccp-macedonia.gov.mk
Tel: (2) 3207 446;
Faks: (2) 3207 434

Bijana Prentoska (projekt-menaxher)
biljana.prentoska@ccp-macedonia.gov.mk
075 273 072

Ivana Ristic (projekt-asistente)
ivana.ristic@ccp-macedonia.gov.mk
070 463 220

PROGRAMI I SHTATË KORNIZË 2007-2013



Hulumtimi dhe zhvillimi teknologjik në Bashkimin Evropian kanë fituar pamje të re, jo vetëm në aspektin sasior (52,52⁴ miliardë euro në periudhën 2007-2013), por edhe në aspektin cilësor (me zgjerimin e listës së shfrytëzuesve dhe sektorëve potencialë). Agjenda e re e Lisbonës është e realizueshme vetëm nëse shfrytëzohen më mirë kapacitetet hulumtuese evropiane, të cilat do t'i transformojnë rezultatet shkencore në prodhimet, proceset dhe shërbimet e reja. Qendrat hulumtuese, ndërmarrjet, administratat, shtetet, agjencitë, odat ekonomike, universitetet dhe shoqatat tani mund të sigurojnë lehtë mjete financiare nga BE për realizimin e bashkëpunimit trans-nacional, krijimin e rrjetave, rritjen e lëvizshmërisë dhe kapaciteteve, organizimin e ngjarjeve të përbashkëta dhe shkencat e aplikuara, krijimin e veglave dhe këmbimin e përvojave dhe njohurive të fituara.

Ky program përfshin aktivitete të shumëllojshme hulumtuese, duke filluar nga hulumtimi i politikave, deri te hulumtimet më të komplikuar teknologjike. Projekti financohet nga Programi i shtatë kornizë dhe quhet EU-27 Watch. Qëllimi i projektit është promovimi i zgjerimit si politika më e suksesshme e Bashkimit Evropian, duke i thyer lajthitjet për “mjeshtrit polakë⁵” dhe në bazë të rezultateve të hulumtimit të realizuar në të gjitha shtetet-anëtare të BE-së. Projekti ka filluar si EU-25 Watch në vitin 2005, kur në BE ka pasur 25 shtete-anëtare, por edhe Bullgaria dhe Rumania si shtete në proces të aderimit në këtë periudhë. Janë përfshirë edhe Turqia dhe Kroacia, si shtete-kandidate. Për fat të keq, Maqedonia si shtet-kandidat ende nuk është përfshirë në projekt. Hulumtimi realizohet nga organizatat eksperte me renome, nga një prej secilit shtet. Në fillim, kjo është financuar nga Programi i gjashtë kornizë, kurse tani financohet nga Programi i shtatë kornizë dhe quhet EU-27 Watch. Rezultatet e hulumtimit më së shumti shfrytëzohen nga Komisioni evropian, kur dëshiron ta dinamizojë procesin e zgjerimit.

Në 4 nën-programet e cekura në vijim, mund të gjenden pothuajse të gjitha format e organizimit në Republikën e Maqedonisë.

⁴ Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vitin 2008 ka qenë rreth 2 miliardë euro.

⁵ Pas zgjerimit në vitin 2004, në BE janë anëtarësuar 12 shtete nga Evropa qendrore dhe lindore. Është besuar që stabiliteti i BE-së do të priset dukshëm, meqë këto vende kanë qenë të varfëra dhe që do të shkaktohet zhvendosje masive nga lindja drejt Evropës perëndimore. Në këtë periudhë u përhap fama e mjeshtërve të ujit, të cilët janë zhvendosur nga Polonia në Britaninë e Madhe.

Nën-programi	Shuma	Shfrytëzuesit potencialë (RM)
I. BASHKËPUNIMI	32,36 miliardë €	
- Shëndetësi		Përkrahja e spektrit të gjerë të aksioneve hulumtuese, të realizuara në bashkëpunim trans-nacional me klinikat, asociacionet profesionale, OJQ-të, fakultetet, konsumatorët, qendrat hulumtuese, administratat, agjencitë, etj.
- Ushqim, bujqësi, bioteknologji		
- Teknologjitë informatike dhe komunikative		
- Nano-shkenca, nano-teknologjia, materialet dhe teknologjitë e reja të prodhimit		
- Energjia		
- Mjedisi jetësor		
- Transporti (me aeronautikë)		
- Shkenca socio-ekonomike dhe humaniste		
- Siguria dhe kozmosi		
II. IDETË	7,46 miliardë €	
Të gjitha hulumtimet e ekipeve të ndara, që vlerësohen nga kolegët-hulumtuesit evropianë		Institucionet, qendrat hulumtuese, agjencitë, odat, fakultetet, asociacionet, etj.
III. NJERËZIT	4,728 miliardë €	
Përforcimi i potencialit njerëzor në hulumtim dhe teknologji në Evropë - partneritetet mes industrisë dhe universiteteve		Shoqatat profesionale, industrinë, universitetet, institucionet shkencore, etj.
IV. KAPACITETET	4,217 miliardë €	
- Hulumtimet rajonale në klasterë	1,83 miliardë €	Pushtetet lokale, odat, universitetet, shoqatat e qytetarëve, institucionet shkencore, administratat, etj.
- Zhvillimi i potencialit të plotë hulumtues në rajonet më të largëta të BE-së		
- Hulumtimi për të mirën e MPS-së		
- Shkenca e çështjeve shoqërore		
- Aktivitetet horizontale të bashkëpunimit ndërkombëtar		
- Aksionet jonukleare të Qendrës së përbashkët hulumtuese		

Republika e Maqedonisë merr pjesë si anëtare fuqiplote e Programit të shtatë kornizë dhe në mbarë vendin ka të a.q. kontakt-pika, gjegjësisht persona përgjegjës për promovimin e programit dhe ndihmën e personave/institucioneve të interesuara për pjesëmarrje. Në vijim jepet lista:

<p>1. Vladimir Risteski Kontakt-pika nacionale për TIK Nr. kontrollues 20191 Agjencia për komunikime elektronike Dimitrie Çupovski 13 Tel: (2) 3289 200; 071 368 481 vladimir.risteski@aec.mk Shkurtesa e programit FP7-ICT</p>	<p>2. Valentina Zhilevska - Pançovska Kontakt-pika nacionale për infrastrukturë Nr. kontrollues 20197 Fakulteti i ndërtimtarisë Partizanski Odredi 24 Tel: (2) 3116 066; 070 591 522 Shkurtesa e programit FP7-INFRASTRUCTURES</p>
<p>3. Valentina Zhilevska - Pançovska Kontakt-pika nacionale për transport Nr. kontrollues 20198 Fakulteti i ndërtimtarisë Partizanski Odredi 24 Tel: (2) 3116 066; 070 591 522 Shkurtesa e programit FP7-TRANSPORT</p>	<p>4. Jasmina Çallovska Kontakt-pika nacionale për mjedis jetësor Nr. kontrollues 21096 Fakulteti i makinerisë Karposh 2 pn Tel: (2) 3099 278; 070 382 934 Shkurtesa e programit FP7-ENVIRONMENT</p>
<p>5. Trpe Ristoski Kontakt-pika nacionale për BIO (bio-teknologji) Nr. kontrollues 20207 Fakulteti për veterinë Tel. (2) 3240 700; 075 404 224 Shkurtesa e programit FP7-KBBE</p>	<p>6. Natasha Markovska Kontakt-pika nacionale për energjetikë Nr. kontrollues 20204 ASHAM Tel. (2) 3235 427; 070 384 236 Shkurtesa e programit FP7-ENERGY</p>
<p>7. Violeta Atanasovska Kontakt-pika nacionale për arsim dhe shkencë Nr. kontrollues 20232 Ministria e arsimit dhe shkencës Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn Tel. (2) 3140 186; 076 485 058 Shkurtesa e programit FP7</p>	<p>8. Aleksandar Tutnovski Kontakt-pika nacionale për SSH (Shkencat socio-ekonomike dhe humaniste) Nr. kontrollues 21099 Ministria e arsimit dhe shkencës Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn Tel. (2) 3140 186; 076 485 053 Shkurtesa e programit FP7-SSH</p>
<p>9. Violeta Atanasovska Kontakt-pika nacionale për INCO (bashkëpunimi ndërkombëtar shkencor) Nr. kontrollues 20215 Ministria e arsimit dhe shkencës Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn Tel. (2) 3140 186; 076 485 058 Shkurtesa FP7-INCO</p>	<p>10. Violeta Atanasovska Kontakt-pika nacionale për Regional Nr. kontrollues 20248 Ministria e arsimit dhe shkencës Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn Tel. (2) 3140 186; 076 485 058 Shkurtesa FP7-REGIONAL</p>

11. Marina Nikolovska

Kontakt-pika nacionale për JRC
(qendrat e përbashkëta hulumtuese)
Nr. kontrollues 20194
Ministria e arsimit dhe shkencës
Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn
Tel. (2) 3140 186
Shkurtesa FP7-JRC

12. Marina Nikolovska

Kontakt-pika nacionale për shëndetësi
Nr. kontrollues 20196
Ministria e arsimit dhe shkencës
Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn
Tel. (2) 3140 186
Shkurtesa FP7-HEALTH

13. Stanka Petkovska

Kontakt-pika nacionale për drejtësi dhe financa
Nr. kontrollues 20200
Ministria e arsimit dhe shkencës
Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn
Tel. (2) 3140 189; 076 485 045
Shkurtesa FP7-LEGALFINANCIAL

14. Stanka Petkovska

Kontakt-pika nacionale për ide
Nr. kontrollues 20197
Ministria e arsimit dhe shkencës
Mito Haxhi-Vasilev Jasmin pn
Tel. (2) 3140 189; 076 485 045
Shkurtesa FP7-IDEAS

15. Anita Grozdanov

Kontakt-pika nacionale për SME (NVM- ndër-
marrje të vogla dhe të mesme)
Nr. kontrollues 20193
Universiteti Sh. Qirili dhe Metodi
Fakulteti teknologjik-makinerik
Ruxher Boshkovic 16
anita@tmf.ukim.edu.mk
Tel. (2) 3088 657; 075 303 578
Shkurtesa FP7-SME

16. Anita Grozdanov

Kontakt-pika nacionale për NMP (nano-shkenca,
nano-teknologjik, materiale dhe teknologji të
reja prodhimi
Nr. kontrollues 20192
Universiteti Sh. Qirili dhe Metodi
Fakulteti teknologjik-makinerik
Ruxher Boshkovic 16
anita@tmf.ukim.edu.mk
Tel. (2) 3088 657; 075 303 578
Shkurtesa FP7-NMP

17. Bozhin Donevski

Kontakt-pika nacionale për Mobility (lëvizsh-
mëria e hulumtuesve)
Nr. kontrollues 20202
Universiteti Sh. Qirili dhe Metodi
Ivo Lola Ribar pn
7000 Manastir
bozhin.donevski@ukio.edu.mk
Tel. (47) 207 702; 070 278 753
Shkurtesa FP7-PEOPLE

Vërejtje:

Kontakt-pikat nacionale për EUROATOM, SIS
(Shkenca në shoqëri), SECURITY (Siguria) dhe
SPACE (Programi evropian për kozmosin) nuk
janë emëruar sërish.

TË RINJTË NË AKSION 2007-2013



Ardhmëria e çdo shoqërie, përfshirë edhe shoqërinë evropiane, janë të rinjtë. Për këtë arsye, Bashkimi Evropian e nxit bashkëpunimin mes të rinjve, nismave të tyre lokale dhe ju jep mundësi të udhëtojnë dhe ta njohin shumëllojshmërinë kulturore në Evropë, ta promovojnë shtetësinë evropiane dhe të mësojnë diçka, si dhe të angazhohen në ndërtimin e Evropës. Në periudhën 2007-2013 janë siguruar 885 milionë euro për programin “Të rinjtë në aksion” me shpresë që të ndihmohet në plotësimin e nevojave të të rinjve, përmes pesë aksioneve:

Aksioni 1. Të rinjtë në Evropë (265,5 milionë euro)

Ky aksion ofron mundësi të jashtëzakonshme për takimin e grupeve të të rinjve. Këmbimi ka dimension pedagogjik dhe joformal të mësimi, si dhe dimension të vlerave, kurse grupet i hulumtojnë temat e përbashkëta dhe mësojnë për kulturat e njëri-tjetrit. Gjithashtu, mbështeten edhe projektet lokale, rajonale dhe nacionale të të rinjve dhe pastaj të rrjetohen organizatat e shteteve të ndryshme. Për ta rritur pjesëmarrjen e të rinjve, përkrahjen projektet evropiane për këmbimin e ideve, përvojave, metodologjive dhe aktiviteteve lokale, rajonale dhe nacionale.

Aksioni 2. Puna vullnetare në Evropë (203,55 milionë euro)

Me këtë aksion, të rinjtë e moshës 13-30 vjeçare mund të kalojnë nga 12 muaj në ndonjë shtet evropian si vullnetarë evropianë, për të ndihmuar në ndonjë projekt lokal në fusha të ndryshme: politika sociale, mjedisi jetësor, arti dhe kultura, zhvillimet e reja teknologjike, sporti, etj.

Aksioni 3. Të rinjtë në Evropë (53,1 milionë euro)

Ky aksion i përkrah projektet rinore me shtetet e treta, me qëllim të promovimit të këmbimit rinor, zhvillimit të partneriteteve dhe rrjetave, me theks të posaçëm në dialog, kuptim të ndërsjellë dhe tolerancë, vetëdije ndërkulturore dhe solidaritet, thyerjen e paragjykimeve dhe stereotipeve dhe kuptohet, zhvillimit të shoqërisë qytetare dhe përforcimit të demokracisë. Ky aksion përfshin edhe shtete tjera nga Amerika jugore, Afrika, Karaibet, Azia, etj.

Aksioni 4. Sistemet për përkrahjen e të rinjve (132,75 milionë euro)

Ky aksion i zhvillon strukturat për përkrahjen dhe rolin e atyre që punojnë me të rinjtë dhe organizatat rinore. Qëllimi është të zhvillohen organizatat joqeveritare rinore evropiane/ndërkombëtare, që kontribuojnë në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve të rinj në jetën publike dhe në shoqëri. Këtu bëjnë pjesë bashkëpunimet rinore në kuptimin më të gjerë. Çdo vit përcaktohen prioritetet që do të financohen (2007 ka qenë viti evropian për mundësi të barabarta, kurse 2008 është viti i dialogut ndërkulturor).

Aksioni 5. Përkrahja e bashkëpunimit evropian të të rinjve (35,4 milionë euro)

Të rinjtë nga shumë shtete kanë mundësi të ballafaqohen dhe diskutojnë për tema të ndryshme, njëherazi duke mësuar diçka më tepër për njëri-tjetrin. Për këtë arsye, ky aksion e përkrahë organizimin e dialogut strukturor të pjesëmarrësve të ndryshëm, seminareve rinore nacionale dhe transnacionale dhe ndihmon në zhvillimin e politikave për të rinjtë.

Prëfimet e vullnetarëve evropianë në Maqedoni

Indre Zdančiūtė nga Lituania është vullnetare në Republikën e Maqedonisë prej vitit 2008 në Qendrën për vullnetarë në Shkup the thotë: Personalisht besoj se njëra prej përfitimeve nga anëtarësimi i Lituanisë në BE është pjesëmarrja në programin ERASMUS, përmes të cilit ka studiuar një vit në Itali dhe tani jam në Maqedoni, përmes programit për vullnetarë, të financuar nga Komisioni Evropian. Përveç kësaj, e kam përmirësuar dukshëm njohjen e gjuhës angleze, frënge dhe italiane dhe kam mësuar disa fjalë themelore në maqedonisht. Ndjenja e të qenit evropian dhe krijimi i miqësive të shumta ndërkombëtare është e përkryer!



Margot Reis nga Franca është vullnetare në Republikën e Maqedonisë prej vitit 2008, gjithashtu në Qendrën për vullnetarë në Shkup. «Liria të jetohej dhe studiohej në cilindo vend në Evropë është liri e madhe. Kam 21 vjet dhe nuk më kujtohen pikë-kalimet kufitare nga e kaluara, kur me prindërit kemi udhëtuar në vendet fqinje. BE ma dha mundësinë ta zbuloj botën, të jem më e hapur për pranimin e kulturave tjera. Pas qëndrimit njëvjeçar në Gjermani si student, kam fituar mundësinë ta zbuloj Maqedoninë, falë programit për këmbimin e vullnetarëve, të mbështetur nga Komisioni Evropian. Aktualisht jetoj në Shkup, së bashku me kolegët evropianë nga Lituania, Letonia, Republika e Çekisë, Portugalia, Spanja, madje edhe Islanda. Së bashku e kemi zbuluar dhe kënaqemi në Maqedoni, duke mësuar diçka më shumë për fqinjët tonë evropianë. Çdo ditë më rritet habia nga pasuria kulturore e Evropës, në këtë shtet të vogël.



Të rinjtë nga Maqedonia mund të bëhen pjesë e rinisë evropiane dhe të kontribuojnë në përmirësimin e jetës së tyre, në korniza evropiane. Nëse deri tani jemi udhëhequr nga motoja “Njihe atdheun për ta dashur më tepër” tash motoja është: Njihe Evropën, për ta dashur më shumë!

Republika e Maqedonisë ende nuk merr pjesë në mënyrë të plotë në këtë program. Kusht për këtë është formimi i Agjencisë nacionale për programet evropiane arsimore dhe lëvizshmëri, që është themeluar në vitin 2008, por edhe më tej nuk është akredituar nga Bashkimi Evropian për ushtrimin e funksionit. Fillimisht, akreditimi është paralajmëruar fillimisht për vitin 2009, pastaj për 2010 dhe tani është prolonguar për 2011. Deri në akreditimin e plotë, do të aplikohen masa përgatitore dhe Maqedonia do të merr pjesë në masë shumë të kufizuar.

Informatat për thirrjet publikohen në ueb-faqen e Agjencisë: www.na.org.mk dhe për momentin këto programe, gjegjësisht nën-programe funksionojnë të hapura për të rinjtë e Maqedonisë:

Nën-aksioni 1.1. Këmbimet rinore
Aksioni 2. Shërbimi evropian vullnetar
Nën-aksioni 4.3 Trajnimi dhe krijimi i rrjetit

Personi përgjegjës për programin Të rinjtë në aksion:
Snezhana Maņeva, snezana.manceva@na.org.mk
tel (2) 3103 736; faks (2) 3119 751

PROGRES (2007-2013)



PROGRESS

Zhvillimi ekonomik dhe politika sociale e BE-së shkojnë së bashku. Ndërmarrjet e zhvilluara nuk mjaftojnë për ta garantuar cilësinë evropiane të jetës dhe për këtë arsye, është e kuptueshme që Bashkimi Evropian ka siguruar 743,29 milionë euro për periudhën 2007-2013 për grantet e punësimit dhe solidaritetit social në BE. Programi përbëhet prej pesë pjesëve:

1) **Punësimi** (144,6 milionë euro) për përkrahjen e realizimit të Strategjisë evropiane për punësim; 2) **Mbrojtja sociale dhe përfshirja** (192 milionë euro) për aplikimin e metodës të hapur të koordinimit në fushën e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes; 3) **Kushtet e punës** (69 milionë euro) për përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë në vendin e punës; 4) **Anti-diskriminimi dhe dallimet** (159 milionë euro) për zbatimin efektiv të parimit të anti-diskriminimit në bazë të racës, prejardhjes etnike, besimit ose bindjes, invaliditetit, moshës ose orientimit seksual, në pajtim me përfitimet e dallimeve dhe 5) **Barazia gjinore** (55 milionë euro) për promovimin dhe përhapjen e vlerave dhe praktikave që rezultojnë me barazi gjinore dhe kuptim më të mirë të çështjeve të lidhura me barazinë gjinore, përfshirë edhe diskriminimin direkt dhe indirekt, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve për promovimin efektiv të barazisë gjinore. Me fjalë tjera, BE do të financojë analiza, studime, hulumtime, anketa, vlerësime dhe do të përgatisë udhëzues, doracakë dhe raporte, do të zhvillojë metodologji dhe tregues të përbashkët, do ta ngrit vetëdijen dhe do të përhapë informata përmes organizimit të konferencave, fushatave mediale, ngjarjeve, seminareve për trajnim dhe do t'i mbështesë aktorët kryesorë në këto fusha.

Një shembull i projektit të komponentës së parë, që e tangon Republikën e Maqedonisë në mënyrë të posaçme, është projekti "**Pasaporta e ndërmarrjes**" e financuar prej janarit 2002 deri në qershor të vitit 2005 për zvogëlimin e papunësisë tek të rinjtë, përmes vetëpunësimit në Gjermaninë lindore. Të rinjtë e motivuar, të përkushtuar dhe inovativ kanë pasur mundësi të fillojnë biznes falë mbështetjes në 4 faza: përcaktimi i profilit, planifikimi, fillimi me punën, konsolidimi dhe zhvillimi. Në çdo fazë, të rinjtë kanë pasur qasje ndaj disa shërbimeve: këshillimet, trajnimin, kualifikimin, mentorimin, qasjen ndaj mikro-kredive për fillimin e biznesit nga fondi special (për shembull, për kredi deri më 5.000 euro, afati i pagesës është 4 vite me kamatë prej 4% pa garantues). Krijohet e a.q. "pasaportë e ndërmarrjes" për përcjelljen e sipërmarrësit, që është pranuar nga bankat e Berlinit, si instrument i vlerësimit të aftësisë kreditore të sipërmarrësve të rinj gjatë kërkesës së kredive të reja.

Ky program mund të shfrytëzohet nga pushtetet lokale, federatat, sindikatat, administratat, shtetet, agjencitë, odat ekonomike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, OJQ-të femërore dhe OJQ-të tjera që merren me çështjet sociale.

Në Republikën e Maqedonisë, organi përgjegjës është Ministria e punës dhe politikës sociale, që kujdeset për promovimin e programit dhe sigurimin e informatave me kohë për palët e prekura nga konkurset e shpallura.

Informatat publikohen në këtë ueb-faqe: <http://www.mtsp.gov.mk/?ItemID=0EF7EC2C34400145A3E672CBF568E242>.

Në vijim jepen kontakt-informatat e dy personave të emëruar nga Ministria, për secilën fushë të financuar nga Programi

PROGRES - Kontakt-pikat nacionala	Aleksandra Spasovska, tel: +389 2 3106 358, aslavovska@mtsp.gov.mk	Ankica Ivanovska Tel. + 389 2 3106 358 aivanovska@mtsp.gov.mk
--	--	--

FUSHA	Kontakt-personi në MPPS	Kontakt-personi në MPPS
Punësimi	Mirjanka Aleksievska Tel: (02) 075 306 128 E-mail: maleksevaska@mtsp.gov.mk	Goran Veleski Tel: (2) 3106 655 E-mail: gveleski@mtsp.gov.mk
Përfshirja dhe mbrojtja sociale	Irena Ristevska Tel: (2) 3106 651 E-mail: iristevska@mtsp.gov.mk	Dushan Tomshiq Tel: (2) 3106 325 E-mail: dtomsic@mtsp.gov.mk
Përmirësimi i kushteve të punës	Olivera Peneva Tel: (2) 3106 469 odimovska@mtsp.gov.mk	Agim Shaqiri Tel: (2) 3116 110 E-mail: Asakiri@mtsp.gov.mk
Anti-diskriminimi dhe dallimet	Elena Grozdanova Tel: (2) 3106 652 E-mail: egrozdanova@mtsp.org.mk	Merdita Saliu Tel: (2) 3106 658 E-mail: msaliu@mtsp.gov.mk
Barazia gjinore	Elena Grozdanova Tel: (2) 3106 652 E-mail: egrozdanova@mtsp.org.mk	Merdita Saliu Tel: (2) 3106 658 E-mail: msaliu@mtsp.gov.mk

EVROPA PËR QYTETARËT (2007-2013)



Ky program i përkushton vëmendje të posaçme aktiviteteve që kanë për qëllim të zhvillojnë lidhje më të afërta mes qytetarëve të Evropës. Për t'i ofruar mundësi për interakcion qytetarëve të saj, BE ka siguruar 215 milionë euro. Qytetarët duhet të marrin pjesë në ndërtimin e Evropës, formësimin e identitetit evropian në bazë të vlerave, kulturave dhe historisë së përbashkët, kultivimit të ndjenjës së përkatësisë, përforcimit të kuptimit të ndërsjellë mes qytetarëve evropianë përmes respektimit dhe kremtimit të shumëllojshmërisë kulturore dhe dialogut interaktiv, si dhe mundësimin të integritit të balancuar në programin e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë qytetare nga të gjitha shtetet-pjesëmarrëse. Programi ndahet në 4 aksione:

Aksioni 1 - Qytetarët aktivë të Evropës (e përkrah vëllazërimin e qyteteve dhe projekteve lokale të qytetarëve dhe ofron masa për përkrahje);

Aksioni 2 - Shoqëria aktive qytetare në Evropë (siguron përkrahje strukturore për organizatat eksperte evropiane që merren me hulumtimin e politikës evropiane publike, përkrahje për organizatat evropiane të shoqërisë qytetare dhe projektet e iniciuara nga organizatat e shoqërisë qytetare);

Aksioni 3 - Së bashku në Evropë (financon ngjarje të dukshme, studime dhe hartimin e veglave për informata dhe përhapje);

Aksioni 4 - Përkujtimi i përbashkët evropian (i ruan lokacionet dhe arkivat kryesorë të lidhur me deportimin dhe përkujtimin e viktimave të fashizmit dhe stalinizmit).


Me ndihmën e këtij programi, qytetarët e Republikës së Maqedonisë mund të udhëtojnë në qytetet evropiane, të ngjashme me vendet e tyre dhe t'i këmbëjnë vlerat e tyre kulturore, historike dhe tradicionale. Prej pushteteve lokale të qyteteve të vëllazëruara evropiane, komunat mund të mësojnë si

Komuna e Manastirit mund të jetë shembull i realizimit mjaft të dobishëm të këtij programi. Komuna e Manastirit është vëllazëruar me shumë komuna në botë, shumica prej të cilave gjenden në Evropë dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në programin «Evropa për Qytetarët». Prej komunave evropiane, Manastiri është vëllazëruar me Epinalin (Francë), Bursën (Turqi), Veliko Trnovo dhe Plevën (Bullgari), Treleborg (Suedi), Kranj (Slloveni), Pozharevc (Serbi) dhe Stari Grad (Beograd, Serbi), Kajzerslauten (Gjermani), Inershtad (Vjenë, Austri) dhe Herceg Novi (Mali i Zi). Të gjitha komunat e cekura kanë përvojë lidhur me përmirësimin e jetës së qytetarëve, që mund të këmbehen. Meqë qytetet janë vëllazëruar dhe qytetarët mund të zhvillojnë marrëdhënie më të afërta, të shoqërohen dhe përforcojnë marrëdhëniet e ndërsjella. Tani kjo mundësohet përmes Programit të BE-së «Evropa për qytetarët».

Më tej, të gjitha komunat (qytetet) janë të vëllazëruara edhe me komuna tjera nga Evropa. BE tani e inkurajon krijimin e rrjeteve mes qyteteve të vëllazëruara. Thënë ndryshe, BE do t'i përkrahë të gjitha nismat që ndërmerren me qëllim që të gjitha komunat e vëllazëruara të vijnë në një pikë dhe ta zhvillojnë rrjetin, me të cilin do të avancohen nismat e ardhshme, si për shembull konkurrimi në programet tjera të BE-së, si që është programi Kultura.

t'i zgjidhin çështjet e ndryshme tematike, duke i siguruar mundësi të vetme për qytetarët e tyre për shoqërim dhe mësim të ndërsjellë. Qytetarët e Maqedonisë mund të organizojnë ngjarje, manifestime dhe kremtime të përbashkëta me kolegët evropianë. Ky program ofron mundësi të posaçme të shihet Evropa, por edhe të sillet Evropa në Maqedoni për t'i promovuar vlerat evropiane.

Shembulli me Komunën e Manastirit do të dukej kështu: Manastiri është vëllazëruar me Epinalin, kurse Epinali me Kierin (Itali), Glembonë (Belgjikë), Loboron (Mbretëria e Bashkuar) dhe me Shvabiholin (Gjermani). Në vijim jepen vetëm komunat e vëllazëruara të Veliko Trnovos, Plevenit dhe Bursës. Supozohet që të gjitha komunat kanë të paktën nga katër komuna të vëllazëruara në Evropë, kështu që numri rritet.



Republika e Maqedonisë ende nuk merr pjesë në këtë program, ndonëse me nënshkrimin e Memorandumit për mirëkuptim dhe pagesës së biletës hyrëse është paraparë pjesëmarrja për gjysmën e parë të vitit 2008. Fatkeqësisht, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme, kjo u prolongua për 2009. Ministria e arsimit dhe shkencës është kompetente për këtë program dhe ajo është përgjegjëse për promovimin e programit dhe informimit me kohë të palëve të prekurra në konkurset e shpallura. Informatat publikohen në këtë ueb-faqe: www.mon.gov.mk. Kontakt-personat përgjegjës për programin janë:

1. Suzana Xhamtoska Zdravkovska
 suzana.dzamtoska@mon.gov.mk
 suzana.dzamtoska@hotmail.com
 tel: 076 485 042

2. Katerina Ruseska
 katerina.ruseska@mon.gov.mk
 tel.: 076 446 186

PROGRAMI-KORNIZË PËR KONKURRENCË DHE INOVACIONE (2007-2013)



Keni nevojë për mjete financiare për themelimin ose zgjerimin e ndërmarrjes tuaj? Jeni i ri dhe dëshironi të filloni biznesin tuaj, por keni nevojë për ndihmë financiare dhe profesionale për ta zhvilluar frymën, aftësitë dhe kulturën sipërmarrëse?

Prodhimi i juaj duhet të jetë i standardizuar, por ju nuk dini si ta bëni këtë dhe sa do të kushtojë kjo. A do tu ndihmojë përvoja e suksesshme e ndonjë kompanie evropiane, që e ka kaluar këtë proces? A keni ide për biznes me potencial të lartë për zhvillim, që kërkon shumë investime? A do të kishit dashur ndihmë financiare për aktivitete zhvillimore dhe inovative? Keni ide për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe keni nevojë vetëm për të holla për të filluar me përgatitjet? Dëshironi ta eksploatoni energjinë solare, por banka e juaj ka problem me rrezikun tepër të lartë të idesë tuaj? Si bankë, dëshironi ta rrisni ofertën e kredive për NVM-të, por procedurat e vlerësimit të aftësisë kreditorë të kompanive janë shumë të shtrenjta? Keni nevojë për të realizuar procedura më të shpejta, lira dhe lehta? Komuna e juaj dëshiron ta përmirësojë efikasitetin energjetik, por ka nevojë për inkuorimin e teknologjive të reja dhe më të mira për efikasitet energjetik dhe diversifikim, si dhe burime të ripërtëritshme të energjisë?

Ku me të kaq shumë pyetje?

BE jep përkrahje financiare përmes Programit për konkurrencë dhe inovacione, në vlerë prej 3,62 miliardë euro në periudhën 2007-2013. Ndërmarrjet, qendrat hulumtuese, sindikatat, asociacionet, agjencitë, odat ekonomike, korporatat, bankat, fondet investuese dhe shumë tjerë në Maqedoni mund t'i shfrytëzojnë këto mundësi të volitshme, në formë të GRANTEVE. Le të krijojmë ndërmarrje të reja, le ta përmirësojmë eksportin, le t'i rrisim investimet, le të hapim vende të reja pune dhe le ta përkrahim prodhimtarinë për të mirën e Maqedonisë, por dhe të BE-së.

Ky program përbëhet prej tre pjesëve: 1) Programi për sipërmarrësi dhe inovacione; Programi për përkrahjen e politikës së teknologjisë informatike-kompjuterike (TIK) dhe 3) Programi për energji inteligjente në Evropë.

Programi për sipërmarrësi dhe inovacione vlen 2,17 miliardë euro (430 milionë euro eko-inovacionet) dhe siguron qasje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në mjetet financiare dhe investimet në inovacion, përmes rritjes së vëllimit të kapitalit (garancive për borxhe dhe mjete), krijimit të klimës së volitshme për bashkëpunim me NVM-ve (posaçërisht në zonat tejkuftare) dhe sigurimit të shërbimeve afariste për përkrahjen e NVM-ve. Këto programe e mbështesin edhe inovacionin, përmes partneriteteve (publike-private, sektorëve, grupeve, transferit të teknologjisë, diturisë, shërbimeve të reja), eko-inovacioneve përmes

Shembull për këtë është projekti për fitimin e energjisë përmes tretjes anaerobe të mbeturinave të kafshëve (nga therja e gjedhit dhe përpunimi i mishit), që është rrezik për mjedisin jetësor dhe shkakton rrezik të mundshëm për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse që janë të rrezikshme për fondin e kafshëve dhe njerëzit. Hedhja e tyre e pakontrolluar shkakton mundësi për përhapjen e sëmundjeve përmes kanalizimit publik. Me ndërtimin e stacionit për biogaz, ku me procesin e tretjes anaerobe do të lirohen mbeturinat e kafshëve, do të prodhohet energjia, do të pengohet hedhja e mbeturinave të kafshëve gjatë therjes dhe ato do të trajtohen në mënyrë efikase. Në këtë mënyrë do të zvogëlohen shpenzimet për deponimin dhe shkatërrimin e mbeturinave që transformohen në biogaz, energji elektrike dhe mbeturina artificiale.

përkrahjes së ndërmarrjes së teknologjive inovative, lidhjes së zhvillimit të eko-shërbimeve dhe promovimit të eko-inovacioneve, promovimit të qasjes së re të integruar drejt menaxhimit me mjedisin jetësor dhe prodhimin e prodhimeve ekologjike. Kjo rezulton me ndotje më të ulët dhe shfrytëzim optimal të burimeve.

Kushtet për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në këtë program janë plotësuar që në vitin 2007. Për programin përgjegjëse

është Ministria e ekonomisë. Maqedonia merr pjesë vetëm në nën-programin e parë: Programi për sipërmarrësi dhe inovacione. Pjesëmarrja në nën-programin e dytë dhe të tretë pritet në vitin 2010. Për këtë vit, përgjegjëse është Ministria e ekonomisë dhe Qendra informative dhe inovative evropiane (EIICM). Në vijim jepen kontakt-informatat:

<p>Ministria e ekonomisë www.economy.gov.mk Koordinator nacional: Ardiana Abazi Ramadani tel: (2) 3093 453 ardiana@economy.gov.mk</p>	<p>EIICM - partner i Enterprise Europe Network (www.eiicm.com.mk) Projekt-menaxher: doc d-r Viktor Stojmanovski tel: (2) 3293 200 viktor@mf.edu.mk</p>
Anëtarë të EIICM Konzorciumit:	
<p>Universiteti Sh. Qirili dhe Metodi www.ukim.edu.mk Kontakt-personi: Do të emërohet shpejtë Tel: (2) 3293 200; Faks: (2) 3293 202 eicm@ukim.edu.mk</p>	<p>Oda ekonomike e Maqedonisë www.mchamber.gov.mk Kontakt-personi: Elena Milevska Tel: (2) 3224 023; Faks: (2) 3244 088 elenam@mchamber.mk</p>
<p>Agjencia për përkrahjen e sipërmarrësisë në RM www.apprm.gov.mk Kontakt-personi: Maja Taseva Tel: (2) 3120 132; Faks: (2) 3135 494 eiicm@apprm.gov.mk</p>	<p>Fondacioni për menaxhim dhe hulumtim industrial www.mir.org.mk Kontakt-personi: Gabriela Kostovska Bogoevska Tel: (2) 3077 008; Faks: (2) 3092 814 eiicm@mir.org.mk</p>

JETA PLUS (LIFE +)



Republika e Maqedonisë ndoshta nuk mund të krenohet me ekonomi të fuqishme, por me siguri kemi hapësirë të jemi të kënaqur me atë që na e ka dhuruar natyra. Në Evropë ekzistojnë gjithsej nëntë lloje të peizazhit dhe në Maqedoni janë të pranishme që të gjitha! Mishngrënësit më të mëdhenj të Evropës jetojnë në Maqedoni (arusha, luqerbulli, ujku, etj). Gjithashtu, Maqedonia konsiderohet edhe si a.q. “pikë kritike” si pikë më veriore, më lindore, më jugore dhe më perëndimore për gjetjen e shumë llojeve të bimëve. Pothuajse të gjitha zogjtë-grabitqarë nga direktiva evropiane për mbrojtjen e llojeve të egra të zogjve mund të hasen në Maqedoni. Kjo e sjell Maqedoninë në Bashkimin Evropian!

Programi LIFE+ financon aktivitete në fushat e mjedisit jetësor, mbështetë projekte për mbrojtjen e natyrës, për informim dhe komunikim publik me mjedisin jetësor dhe financon aktivitete që rrjedhin nga Plani aksionar i gjashtë ekologjik i Bashkësisë Evropiane. Buxheti i programit për vitet 2007-2013 është mbi 2 miliardë euro dhe programi ka tre komponenta: 1) Natyra dhe shumëllojshmëria biologjike; 2) Politika dhe sundimi ekologjik; 3) Informatat dhe komunikimi.

Rrëfimi i suksesshëm i Maqedonisë për shfrytëzimin e mjeteve të këtij programi mund të jetë Lukovo Pole, që gjendet në anën verilindore të Korabit, në pjesën e Malit Sharr. Lukovo Pole është fushë dhe vendbanim natyror me prioritet për Bashkimin Evropian, meqë jetojnë arushat, luqerbulli, edhet e egra dhe shumë lloje tjera të egra. Në aspektin e bimëve, me rëndësi të posaçme është afërsia me grykën e Agjina Reka, njëherazi vendbanimi më jugor i dellinjës norvegjeze.

Në fazën e parë do të bëhet hulumtimi, kurse në të dytën do të sigurohen mjete për mbrojtje më të mirë të shumëllojshmërisë biologjike dhe krijimin e politikës më të mirë për mbrojtjen e natyrës në kuadër të zonës. Në fund, parku nacional mund të fitojë edhe mjete për promovimin e pasurive të jashtëzakonshme natyrore dhe për mbrojtjen e natyrës dhe potencialeve turistike dhe shkencore-hulumtuese. Në këtë mënyrë, do të zgjidhet çështja e strukturës së vizitorëve - qendra për vizitorë, filmi për llojet në këtë zonë dhe për aktivitetet që ndërmerren, ueb-aplikacionet dhe të ngjashme.

Natyra dhe shumëllojshmëria biologjike

Kjo komponentë e programit financon projekte për mbrojtjen e natyrës dhe shumëllojshmërisë biologjike, kontribuon në realizimin e direktivave për llojet e egra të zogjve dhe kafshëve tjera, si dhe vendbanimeve dhe është praktika më e mirë për ndërlidhje në hulumtimin e aplikimit praktik të politikës. Këto projekte janë investime të qëndrueshme afatgjate në territorin e NATURA 2000, ku lejohet madje edhe blerja e tokës për ruajtjen e vendbanimeve të parapara në direktivë, kurse në Maqedoni ka shumë vendbanime të këtilla. Bashkimi Evropian kontribuon edhe në ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, përmes financimit të projekteve me të cilat zvogëlohet ulja e shumëllojshmërisë biologjike, të cilat janë inovacion, për shkak se dallohen nga aktivitetet e parapara me direktivat për zogjtë e egra, llojet e egra dhe vendbanimet e tyre.

Politika dhe sundimi ekologjik

Kjo komponentë e programit e mbështetë zbatimin, plotësimin dhe zhvillimin e politikës ekologjike dhe legjislationit të BE-së, i përkrahë projektet me të cilat më lehtë tejkalohen dallimet mes hulumtimit dhe zhvillimit dhe i promovon zgjidhjet inovative për përfshirje më të madhe publike. Programi financon aktivitete në fushën e ndryshimeve klimatike, ujit, ajrit, tokës, mjedisit urban jetësor, zhurmës, materieve kimike, shëndetësisë dhe mjedisit jetësor, mbeturinave dhe burimeve natyrore, pyjeve, inovacioneve dhe qasjes strategjike.

Informatat dhe komunikimi

Qëllimi i këtij programi është komunikimi dhe ngritja e vetëdijes publike për mjedisin jetësor, parandalimin e zjarreve pyjore dhe financimin e trajnimit për zjarrfikësit dhe rojet e zjarreve pyjore. Përmes projekteve të këtilla promovohen vlerat evropiane, më së shpeshti përmes konferencave dhe ekspozitave, dizajnit, përgatitjes dhe shtypjes së broshurave, posterëve dhe afisheve, fushatave promovionale, filmave dhe materialeve tjera audio-vizuale, si dhe ueb-aplikacioneve dhe forumeve.

MËSIMI I PËRJETSHËM 2007-2013



Education and Culture DG

Shtetet-anëtare vendosin vetë për sistemet e tyre arsimore, meqë arsimit është një prej fushave "më të ndjeshme". Megjithatë, Komisioni Evropian ka rol të përkrahësit dhe promovuesit të arsimit, së këndejmi i ndihmon shteteve-anëtare në plotësimin e detyrave të përcaktuara me ndihmën e programit *Mësimi i përjetshëm*. Sipas programit për arsim, në vitin 2010 duhet të realizohen këto detyra: të mos rritet numri mesatar i nxënësve (10%) që çregjistrohen nga shkolla më herët; numri i nxënësve që e kanë kryer matematikën, shkencën dhe teknologjinë të rritet për 15% dhe të zvogëlohet dallimi gjinor tek këto lëndë; 85% e personave të moshës 22-vjeçare ta kenë kryer arsimin e mesëm; numri i 15-vjeçarëve që arrijnë rezultate të këqija në lexim, matematikë dhe shkencë të përgjysmohet dhe të arrihet rritje prej 12,5% në aspekt të pjesëmarrjes mesatare të të punësuarve në arsimin për të rritur.

Motoja e programit *Mësimi i përjetshëm* është "Asnjëherë nuk është vonë për mësim". Qëllimi kryesor i këtij programi është kontributi në zhvillimin e Bashkimit Evropian në shoqëri të avancuar, të bazuar në dituri, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe me kohezion më të madh social. Programi ka buxhet prej rreth 7 miliardë euro për periudhën 2007-2013 dhe ndahet në katër nën-programe, një program transversal dhe *Programin Zhan Mone*.



1. Jan Amos Komenski (1592-1670) - mësimdhënës çek, shkencëtar, edukator dhe shkrimtar. Ka qenë ipeshk protestant dhe është autor i librit *Didactica Magna*. Njihet si "mësimdhënës i popujve" dhe llogaritet si babai i arsimit bashkëkohor. Jo rastësisht ky program e mban emrin e tij. Grupi në shënjestër të këtij programi është arsimit parashkollor dhe shkollor, deri në arsimin e lartë, si dhe institucionet që sigurojnë arsim të këtij niveli. Qëllimet e programit janë:

Zhvillimi i modelit të orientimit profesional. Projekti e ka synuar zhvillimin e modelit për orientim profesional dhe sistem për orientimin e nxënësve në kuptim të nevojave të tregut të punës. Është hartuar internet-sistem kompleks për zgjedhjen e karrierës në nivel rajonal, me ndihmën e partnerëve nga Irlanda dhe Hungaria, që sot është nacional. Modeli i orientimit profesional i ka marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe është realizuar edhe trajnimi adekuat profesional. Në këto kushte, të rinjtë dhe më të moshuarit kanë mundur të sjellin vendime konkrete për karrierën e tyre. Për bashkëpunim më efikas mes këshilltarëve, organeve rajonale dhe organizatave që kanë marrë pjesë në projekt, është nevojitur trajnimi plotësues i tyre. Qendrat për punësim e kanë realizuar projektin në 8 qendra rajonale dhe 11 institucione-nikoqire në Irlandë. Këshilltarët për orientim profesional dhe autoritetet e fushave (18) kanë vijuar përgatitjen gjuhësore, profesionale dhe kulturore dhe janë nisur për në vizitë studimore në Irlandë, për dy javë. Pas kësaj vizite, qendrat e punësimit dhe organizatat partnere kanë hartuar model kompleks rajonal për orientim profesional, që gjendet në ueb-faqen www.epalya.hu që është bërë nacional në prill 2005.

- Deri në fund të projektit, duhet të përfshihen të paktën 3 milionë nxënës në aktivitetet e përbashkëta arsimore;
- Zhvillimi i diturisë për dalimet e kulturave evropiane mes të rinjve dhe edukatorëve dhe
- Ndhima e mijëra njerëzve në nxënien a aftësive për zhvillim persona, punësim të ardhshëm dhe shtetësi aktive evropiane.



2. Leonardo da Vinçi (1452 - 1519) - matemtikan, shkencëtar, inxhinier, inovator, skulptor, arkitekt, botanik, piktor, muzikant dhe shkrimtar italian.

Më së shpeshti përshkruhet si arketip i personit të rilindjes. Llogaritet si një prej piktorëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave dhe si person me më së shumti prirje. Jo rastësisht programi i dedikuar për nevojat mësimore të arsimit profesional, pa arsimin e lartë profesional e mban emrin e Leonardo da Vinçit. Qëllimet e programit janë:

- Deri në fund të programit, numri i vendeve të punës në praktikë, në kompanitë duhet të rritet për 80.000 në vit;
- Sigurimi dhe shfrytëzimi i diturisë, aftësive dhe kualifikimeve për zhvillim personal;
- Përmirësimi i cilësisë dhe inovacioneve në arsimin profesional dhe
- Lëvizshmëria e njerëzve.



3. Erasmus Desierius (1466 - 1536) - humanist i rilindjes holandeze dhe teolog i kishës katolike. Ka udhëtuar në qendrat më të mëdha të diturisë së asaj kohe, si Parisi dhe Kembrixhi. E ka lënë pasurinë në Universitetin e Bazelit dhe me këtë është bërë pionier i granteve për lëvizshmëri, të cilat tani emërohen sipas tij. Përmes programeve sigurohen grante për lëvizshmëri të studentëve/profesorëve, rrjetet dhe partneritetet në arsimin e lartë. Prej këtu rrjedhin edhe qëllimet e këtij nën-programi:

"Evropa me shkrim" është projekt që rrjedh nga shkollat-partnere të Komenskit, që e thekson historinë e pasur evropiane dhe traditat e saj kulturore, përmes mësimit të grafikës së hapësirave publike në disa qytete evropiane. Në këtë projekt trevjeçar janë përfshirë katër shkolla për dizajn grafik. Përveç këmbimit të përvojave, janë këmbyer edhe kontaktet me institucionet e ndryshme evropiane dhe është krijuar ueb-faqja në disa gjuhë. Në këtë projekt përfshihen Amsterdami, Madridi, Praga dhe Riga. Çdo vit, grupi i nxënësve ka mësuar tema të ndryshme. Tema e parë ka qenë "Qytetet me shkrim». Çka tregojnë qytetet? Është vërejtur dhe analizuar grafika informative, mënyrat e promovimit të identitetit, frazat poetike, etj. Tema tjetër ka qenë "Lëndët dhe personalitetet me shkrim" ku nxënësit i kanë vërejtur objektet e mëdha dhe të vogla në qytetet, si që janë llojet, markat tregtare, automobilat, transporti publik, moglet, etj. Gjithashtu, janë vërejtur edhe kafshët, llojet dhe rasat e tyre në qytete, etj. Në fund, janë vëzhguar edhe njerëzit - emrat e tyre, tatuazhet, markat e veshjes dhe dukuria e

tyre fizike. Faza e fundit e projektit - Grafika lokale, globale dhe e përbashkët, ka qenë sintezë e punës së kryer gjatë dy viteve paraprake në të gjitha katër qytetet. Identitetet lokale janë krahasuar me identitetin global dhe projekti i ka mundur secilin qytet ta përcaktojë identitetin lokal. Janë cekur ndikimet mes qyteteve të ndryshme dhe përmes studimeve krahasuese dhe analizës së informatave të mbledhura, nxënësit kanë pasur mundësi ta gjejnë identitetin grafik evropian.

Dimensioni evropian i mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollë ka qenë vazhdimisht e pranishme. Ky projekt i përpunuar mirë e ka rritur dukshëm vetëdijen për globalizimin dhe integrimin kulturor të të rinjve në Evropë. Materialet dhe përvoja për nxënësit dhe mësimdhënësit mund të gjenden në ueb-faqen e projektit www.written-europe.org. Projekti është prezantuar në konferenca, muze, asociacione dhe institucione. Janë organizuar edhe disa ekspozita.



dy shtyllat e programit të tij. Ka besuar që universiteti duhet t'i aftësojë studentët për pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe jetën e përditshme. Së këndejmi, ky program ofron grante për mësim dhe mësimdhënies, projekte arsimore për të rriturit, të dedikuara për trajnuesit dhe ata që mësojnë. Qëllimet e këtij nën-programi janë:

- Deri në vitin 2013 duhet të përkrahjet lëvizshmëria e 7.000 pjesëmarrësve individualë, të përfshirë në arsimin për të rritur;
- Përgjigjja e sfidave arsimore të popullatës së rritur në Evropë;
- Avancimi i diturisë dhe aftësive të popullatës së rritur.

Mësoni gjuhë të huaja, së bashku me nipërit tuaj. Projekti i shfrytëzon marrëdhëniet e afërta mes gjeneratave, gjyshërve dhe nipërve, ku ata motivohen mes vete për mësimin e gjuhëve përmes aktiviteteve të përbashkëta. Tek popullata më e moshuar, që nuk ka pasur mundësi paraprake për mësimin e gjuhëve të huaja, janë vërejtur rezultate të ndryshme. Gjithashtu, është dëshmuar që mësimi i gjuhëve të huaja mund të jetë zbatimës dhe të ndihmojë në tejkalimin e stereotipit se gjuha mund të mësohet vetëm në moshë rinore.

- Që nga fillimi i programit, në aksionet për lëvizshmëri të studentëve duhet të përfshihen gjithsej 3 milionë pjesëmarrës individualë;
- Përkrahja për realizimin e Hapësirës evropiane të arsimit të lartë dhe
- Kontributi për arsimin e lartë dhe arsimin e avancuar profesional drejt inovacionit.

4. Nikolaj Severin Gruntvig (1783-1872) - shkrimtar, mësues, poet, filozof, historian, prift dhe politikan danez. Ai është babai ideologjik i shkollës së mesme popullore, por ka ëndërruar për themelimin e një universiteti të madh nordik. Shkolla e jetës (Shkolla e mesme popullore) dhe Shkolla e pasionit (Universiteti) kanë qenë

Përveç 4 nën-programeve të cekura, programi Mësimi i përgjithshëm i përfshin edhe të a.q. programet transversale, që e synojnë rritjen e cilësisë dhe transparencës së sistemeve arsimore dhe sistemeve trajnuese në shtetet-anëtare dhe shtetet-pjesëmarrëse në program dhe sigurojnë bashkëpunim evropian në fushat e përfshira me dy ose më shumë programe.

Në shumë shtete evropiane, në kohën kur prindërit janë në punë, gjyshërit dhe gjyset kujdesen për fëmijët. Kjo ndodh në Bullgari, Greqi, Itali dhe Spanjë. Prej më të moshuarve pritet ndihmë jo vetëm në aktivitetet e përditshme në shtëpi, por edhe gjatë punimit të detyrave të shtëpisë. Kjo është konsideruar si motivim për t'iu bashkëngjitur nipërve gjatë mësimit të gjuhëve të huaja. Për ta tejkaluar mungesën e vullnetit për mësime, partnerët kanë zhvilluar aktivitete joformale, me të cilat e kanë joshur vëmendjen e tyre. Kanë zbuluar lojëra të ngjashme me ato që shfrytëzohen në mësimdhënie me fëmijët e vegjël, me të cilat përmirësohen aftësitë memorike. Këto lojëra kanë qenë të zbatueshme dhe kanë ndihmuar në krijimin e atmosferës së relaksuar në mësonjëtorë. Gabimet asnjëherë nuk janë të këndshme për të rriturit, kështu që janë theksuar nivelet themelore të njohjes së gjuhës dhe zhvillimi të aftësive bazike folëse. Më të moshuarit janë kënaqur në aspektet sociale të mësimit në klubet joformale me gjyshërit dhe gjyset tjera dhe kanë treguar entuziazëm të madh në garimet e ndryshme gjuhësore, në ekipe me nipërit. Pothuajse nuk ekziston asnjë projekt tjetër për promovimin e gjuhëve për këtë grup në shënjestër. Kështu, është joshur interes i madh dhe kjo është cekur si shembull për shumë ngjarje në mbarë Evropën. Përveç kësaj, projekti ka nivel të jashtëzakonshëm të vijueshmërisë së personave më të moshuar, kështu që tani shumica paguajnë për pjesëmarrje në klube dhe për ta vazhduar mësimin e gjuhës. Më shumë detaje për këtë projekt mund të merren në ueb-faqen e projektit: www.znanie-bg.org

Programi Zhan Mone është nismë e Komisionit Evropian për nxitjen e ligjëratave, hulumtimeve dhe kontributit drejt të a.q. Studimeve të integruara evropiane në institucionet e arsimit të lartë. Programi e përfshin Rrjetin e qendrave evropiane të përsosurisë Zhan Mone (European Centres of Excellence) në institucionet evropiane që njihen nga Komisioni Evropian për hulumtim të cilësisë së lartë dhe ligjëratave në temën «Integrimi evropian». Sot ekzistojnë 97 qendra të këtilla në botë dhe Komisioni i mbështet katedrat Zhan Mone dhe modulet studimore Zhan Mone. Në botë ka 629 katedra të këtilla.

Republika e Maqedonisë ende nuk merr pjesë në mënyrë të plotë në këtë program. Kusht për këtë është formimi i Agjencisë nacionale për programet evropiane arsimore dhe lëvizshmëri, që është themeluar në vitin 2008, por edhe më tej nuk është akredituar nga Bashkimi Evropian për ushtrimin e funksionit. Fillimisht, akreditimi është paralajmëruar fillimisht për vitin 2009, pastaj për 2010 dhe tani është prolonguar për 2011. Deri në akreditimin e plotë, shtetasit e Maqedonisë mund të marrin pjesë në masë shumë të kufizuar. Informatat për thirrjet publikohen në ueb-faqen: www.na.org.mk. Në vijim jepem informatat

Zhvillimi i aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë. Pol Brokman nga Këshilli lokal i Southampton ka udhëtuar për vizitë njëjavore studimore në Maltë, për të mësuar si zhvillohen aftësitë e sipërmarrësisë tek të rinjtë, si dhe t'i frymëzojë për fillimin e biznesit të tyre. Programi e ka përfshirë vizitën e organizatave dhe shkollave lokale për të parë si zhvillohet sipërmarrësia tek rinia e Maltës. Gjatë kësaj vizite, Pol është njohur me punën e inkubatorit «Kordin Business Incubation Centre» dhe e ka vizituar kolegjin e artit dhe teknologjisë (Malta College of Arts Science and Technology), për të parë si zhvillohen interesimi për përpjekjet sipërmarrëse të studentëve. Ai gjithashtu e ka vizituar edhe Qendrën malteze për punësim dhe trajnim (Malta's Employment and Training Corporation), ku funksionon skema e ndihmës përmes ditorisë dhe aftësive për personat e papunësuar, për të hapur biznese të tyre. Në program është përfshirë edhe vizita e Viktor Galeas, Kryetar i Odës ekonomike të Maltës. Pol ka deklaruar: «Takimi me Ministrin ishte jashtëzakonshme dhe kjo e ka rrrumbullakosur vizitën time në Malta. Zotëri Galea ka qenë shumë i hapur për diskutim dhe i ka prezantuar në mënyrë të shkëlqyeshme mekanizmat për hartimin e politikave dhe për komunikim me palët e prekura. Ai i është përgjigjur pyetjeve në mënyrë të palodhshme, duke filluar nga pyetjet strategjike, deri te aspektet konkrete të programit mësimor». Si rezultat nga vizita, Pol ka dizajnuar program për trajnimin e sipërmarrësve për vetëpunësim për organizatën e tij në Southampton. Idenë për biznes-inkubator e ka prezantuar edhe në Këshillin komunal të Southamptonit dhe përvoja e tij është financuar nga Programi transversal i BE-së për vizita studimore.

për kontakt-personat e Agjencisë për mësim të përrjetshëm dhe programet e caktuara të sektorëve.

Personi përgjegjës për Programin Mësimi i përrjetshëm:

Jovan Popovski,
jovan.popovski@na.org.mk, tel (2) 3103 737

Personi përgjegjës për Komenius:

Nikola Jauleski,
nikola@jauleski@na.org.mk,
tel (2) 3103 748

Personi përgjegjës për Leonardo da Vinçi:

Lulesa Iljazi
lulesa.iljazi@na.org.mk
tel.: (2) 3103 731

Personi përgjegjës për Erasmus:

Neda Ahçieva,
neda.ahcieva@na.org.mk,
tel (2) 3103 742

Personi përgjegjës për Grundvig:

Ljupka Bakatxhieva,
ljupka.bakardjieva@na.org.mk,
tel (2) 3109 045

Me shpresë që Republika e Maqedonisë do të përfshihet në këtë program sa më shpejtë, Qendra maqedonase për arsim evropian ia ka dhënë lirinë vetes të paramendojë një rrëfim nga Maqedonia, për t'i ilustruar të gjitha përfitimet që i ofron programi për qytetarët e vendit. Rrëfimi është i paramenduar, për momentin, por kjo mund të bëhet realitet shumë lehtë.

RRËFIMI MAQEDONAS

Familja Stojanovski është familje tipike maqedonase. Nëna Stojanka punon në kopsht për fëmijë, babai Stojan është profesor universitar, vajza e tyre Stojana studion shkencat humane në një universitet në Maqedoni, kurse djali Stole tani e ka përfunduar arsimin e mesëm (hoteleri) dhe i shqyrton mundësitë për hapjen e një restoranti me specialitete të ndryshme të popujve që jetojnë në BE.

Në lagjen ku jeton familja, para ca kohësh kanë ardhur për banim disa familje nga Hungaria, që punon në "Makedonski Telekomunikacii". Këto janë çifte të reja me nga dy fëmijë të moshës 2-4 vjet. Kopshti i fëmijëve ku punon Stojanka nuk është e gatshme t'ia ofrojë shërbimet këtyre familjeve, meqë askush nuk e njej mirë kulturën dhe traditat hungareze dhe nuk e njej gjuhën, që nevojitet për komunikimin e thjeshtë me fëmijët. Fatmirësisht, familjet hungareze njihen mirë me mundësitë e programit Mësimi i përrjetshëm dhe i kanë ndihmuar drejtorisë së kopshtit të kontaktojnë me entet parashkollore në Hungari. Tani Stojanka mëson hungarisht (që paguhet nga pjesa e programit për mësimin e gjuhëve të huaja), drejtoresha e saj organizon projekte të përbashkëta me

kopshtet tjera hungareze nga rrjeti dhe ka këmbim të rregullt të kuadrit për përmirësimin e bashkëpunimit (që paguhet nga programi COMENIUS). Njëherazi, Maqedonia promovohet me sukses në Hungari.

Stojanka ia bart bashkëshortit përvojën e saj i cili falë lidhjeve të saja hungareze ka kontaktuar me disa universitete në Hungari. Duke e shfrytëzuar grantin e lëvizshmërisë nga programi ERASMUS, Stojani ka qëndruar disa muaj në universitetet hungareze dhe e ka sjellë përvojën në universitetin e tij në Maqedoni. Tani studentët e universitetit të tij kalojnë disa muaj duke studiuar në Hungari dhe studentët hungarezë vijnë në Maqedoni. Shpenzimet e qëndrimit mbulohen nga BE-ja, përmes bursave.

Duke u nisur nga përvoja e babait, Stojna është në fund të studimeve universitare dhe tani ka aplikuar për studime post-diplomike në universitetin që është pjesë e rrjetit ERASMUS në Gjermani. Studimet e saj do të vijojnë në Gjermani, Finlandë dhe Spanjë dhe do të vijojë kurse për gjermanisht, finlandisht dhe gjuhën frëngjishte. Shpenzimet e qëndrimit mbulohen nga BE-ja.

Programi Mësimi i përzetshëm ia ka hapur dyert Stoles. Hapja e restorantit është dëshmuar më e komplikuar nga pritjet e tij dhe ai ballafaqohet me dy probleme. Së pari, ka kuptuar që nuk di pothuajse asgjë për punën afariste dhe marketingun, nuk është i aftë për hartimin e planit afarist dhe ka kuptuar që kuzhinat evropiane janë të shumëllojshme. Përveç kuzhinave më të njohura nga vendet fqinje, ai nuk di çfarë ushqimi hanë danezët, irlandezët, letonët, lituanët, etj. Falë programit GRUNDTVIG, Stole është regjistruar në një kurs për planifikim afarist, menaxhim financiar dhe marketing në një prej qendrave arsimore për të rritur. Lidhjet hungareze të prindërve i kanë ndihmuar në kontaktimin e Shkollës së mesme të hotelelerisë në Budapest, ku mësohet lënda e posaçme e Kuzhinave evropiane. Stole i ka lidhur dy shkollat e mesme dhe tani shkolla në Maqedoni punon në inkorporimin e lëndës Kuzhinat evropiane, meqë kolegët e tyre hungarezë i kanë ndihmuar në krijimin e programeve mësimore, si dhe në plotësimin e kualifikimit të kuadrit të mësimdhënësve në Maqedoni. Gjeneratat e ardhshme të nxënësve në Maqedoni do të mund të qëndrojnë për këmbim në Hungari, kurse nxënësit hungarezë mund të mësojnë për kuzhinën e Maqedonisë në Maqedoni. Shpenzimet mbulohen nga programi LEONARDO DA VINCI

Struktura e programit Mësimi i përgjeshëm:

MËSIMI I PËRJETSHËM 2007-2013
(6,970 miliardë euro)

COMENIUS	ERASMUS (370 mil eur/vit)	LEONARDO DA VINCI (215 mil eur/vit)	GRUNDTVIG (38,54 mil eur/vit)
<p>Grante për arsimin para-shkollor dhe shkollor deri në arsimin e lartë dhe institucionet që ofrojnë arsim të këtitillë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Partneritetet (grantet për partneritetet shkollore transnacionale) • Rrjetet (2,843 mil./vit) (grantet për krijimin e rrjeteve të enteve dhe organizatave arsimore në projekte shumëpalëshe) • Lëvizshmëria (24,793 mil./vit) (kualifikimi dhe plotësimi i kualifikimit të nëpunësve arsimore, këmbimi i nxënësve). 	<p>Grante për lëvizshmëri të studentëve/profesorëve, rrjetet dhe partneritetet në arsimin e lartë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizshmëria (351,1 mil./vit) (grantet individuale për studentët/profesorët) • Projektet shumëpalëshe (10,842 mil.eur) (grante për projekte për zhvillim, modernizim dhe inovacion) • Rrjetet (7,6 mil./vit) (grante për krijimin e rrjeteve tematike për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë). 	<p>Grante për nevojat mësimore të arsimit profesional pa arsimin e lartë profesional</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizshmëria (122 mil./vit) (grantet për projekte transnacionale për lëvizshmërinë e personave, trajnim profesional dhe trajnues) • Projektet shumëpalëshe (82,64 mil.eur) (grante për projekte transnacionale për zhvillimin e inovacioneve dhe cilësisë në fushën e trajnimit profesional) • Rrjetet (3,682 mil./vit) (grante për rrjetet tematike transnacionale të standardeve evropiane). 	<p>Grante për mësimdhënie dhe mësim, projekte në arsimin e të rriturve, të dedikuar për trajnuesit dhe ata që mësojnë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizshmëria (2,05 mil./vit) (grante për lëvizshmërinë e trajnimit formal dhe joformal dhe për kuadër mësimor që specializon në arsimin për të rritur) • Projektet shumëpalëshe (14 mil.eur) (grante për projekte për zhvillim, modernizim dhe inovacion në arsimin për të rritur) • Rrjetet (2,557 mil./vit) (grante për krijimin dhe realizimin e rrjeteve Grundtvig në arsimin për të rritur) • Partneritetet (19,32 mil./vit) (grante për krijimin e partneriteteve për arsimin për të rritur) (za u-ewe za vozrasni).

LLL - TRANSVERSAL PROGRAMME

- **E-LEARNING** (8,5 mil eur/vit) - grantet për integrimin e TIK në sistemet arsimore dhe trajnuese në Evropë.
- **DISEMINIMI** (2,864 mil eur/vit) - grantet për përkrahjen e projekteve dhe studimeve që e synojnë përhapjen e rezultateve të programit Mësimi i përgjeshëm
- **GJUHËT** (9,147 mil eur/vit) - grante për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimit të gjuhëve (në mënyrë cilësore dhe sasiore)
- **BASHKËPUNIMI DHE INOVACIONET NË NIVEL TË POLITIKËS PUBLIKE** (6,239 mil eur/vit) - studimet dhe analizat e lidhura me politikat dhe sistemet arsimore

JEAN MONNET

- Përkrahja për aksione, institucione dhe asociacione evropiane që veprojnë në fushën e integritimeve evropiane.

Programet në kuadër të perspektivës financiare 2007-2013

Programet e mëparshme të Bashkësisë	Programet e reja kornizë 2007-2013	Generalen direktorat
Socrates: Comenius, Erasmus, Grundtvig, Lingua, eLearning Leonardo da Vinci Jean Monnet	LLL - Action programme in the field of lifelong learning	Education Culture
Youth	Youth in Action	Ed./Cult
Culture 2000	Culture	Ed./Cult
Media Plus Media Plus Development Media Plus Distribution, Promotion Media Plus Pilot Projects Media Training	Media 2007 1. Support upstream of audiovisual production 2. Support downstream of audiovisual production 3. Pilot projects	Education Culture
Active European Citizenship Programme Town Twinning Support to European projects for debates by NGOs Projects from associations and federations of European integration	Europe for Citizens 1. Active citizens for Europe 2. Active civil society for Europe 3. Together for Europe	Education Culture
Community incentive measures in the field of employment Combating discrimination Combating social exclusion Gender equality	PROGRESS - Programme for employment and Social Solidarity 1. Employment - Working conditions 2. Social protection and social inclusion 3. Anti-discrimination and diversity 4. Gender equality	Employment social affairs
Multiannual Programme for Enterprises (MAP) FP6 Research and Innovation, Life-Environment e-TEN, Modinis, e-Content Intelligent Energy Europe: SAVE, ALTENER, STEER	CIP - Competitiveness and Innovation Framework Programme 1. Entrepreneurship and Innovation Programme 2. ICT Policy Support Programme 3. Intelligent Energy-Europe Programme: SAVE, ALTENER, STEER	Enterprise Industry Energy
Daphne II Fundamental Rights Judicial Cooperation in Civil Matters Support to NGOs in 10 new Member States	Fundamental Rights and Justice 1. Fight against violence, Drug prevention and Information 2. Fundamental rights and citizenship 3. Civil Justice / Criminal Justice	Justice Freedom Security
European Refugee Fund INTI ARGO RETURN	Solidarity and Management of Migration Flow 1. European Refugee Fund 2. European Fund for integration of 3-country nationals 3. External Border Fund 4. European Return Fund	Justice Freedom Security

Porane{nite programi na Zaednicata	Novite ramkovni programi 2007-2013	Generalen direktorat
Preparatory Action in favour of victims of terrorist acts AGIS	Security and Safeguarding Liberties 1. Prevention, Preparedness & Consequence Management of Terrorism 2. Prevention of and Fight against Crime	Justice Freedom Security
LIFE III Life Nature General Mechanism for policy implementation Action programme European environmental NGOs Programme for sustainable urban development Forest focus	LIFE + 1. LIFE Nature and Biodiversity 2. LIFE Environment policy and governance 3. LIFE Information and Communication	Environment
FP6 Food safety and health risks Genomics and biotechnology for health Information society technologies Nanotechnologies, materials, New production processes Sustainable development, global change, ecosystems, aeronautics Citizens and governance Aeronautics and space	FP7 - Cooperation 1. Health 2. Food, Agriculture and Biotechnology 3. Information and Communication Technologies 4. Nanosciences, Nanotechnologies, Materials, new production technologies 5. Energy 6. Environment (including climate change) 7. Transport (including Aeronautics) 8. Socio-economic sciences and humanities 9. Security and space FP7 - Ideas (Fundamental Research)	Research
Marie Curie Actions	FP7 - People 1. Initial training 2. Lifelong training 3. Industry academia 4. Scholarships for international research	Research
Research and Innovation Horizontal research SME Regions of knowledge Research infrastructures INCO Science and society	FP7 - Capacities 1. Research potential 2. Research for the benefit of SMEs 3. Regions of knowledge 4. Infrastructures 5. INCO 6. Science in society	Research

CIP - Katalogizimi i publikimit

Biblioteka nacionale dhe universitare
"Sh. Kliment Ohridski" Shkup

341.171(4-672EU) "2007/13"(083.97)

PROGRAMI i bashkësive/ - Shkup

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur Maqedoni, 2009. - 30
str., illustr. : 20h20 sm.

ISBN 978-9989-185-93-9

a) Bashkimi Evropian - Programet

COBISS.MK-ID 77744138

